




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Në mbështetje të nenit 12 të paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008*), nenit 17 të Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 17 të paragrafit 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 të paragrafit 2 të pikës 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të paragrafit 1 të pikës 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2024, merr:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01. Nr. 214/24 i datës 29.04.2024, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510057-01643-1.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. **Erhan Morina**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.2. **Besmire Bytyqi**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.3. **Armir Vuçitërna**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës – PDK;
 - 2.4. **Valmir Gashi**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës- AAK;
 - 2.5. **Adnan Rexha**, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në pesëmbëdhjetë (15) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktojë çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, t'i zhvillojë procedurat e ankandit publik dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivi*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.214/24
Datë:29.04.2024

